



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY




Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 4.3, lidhur me nenin 37, të Ligjit N.r.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe në përputhje me Planin e Monitorimit Vjetor, Drejtoresha e Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, merr:

VENDIM

Për ndryshimin e Planit të Monitorimit Vjetor

1. Ndryshohet Planit i Monitorimit Vjetor (PMV) i performancës së KRU, të:
 - 1.1. pesha e treguesve kyç të performancës si dhe
 - 1.2. emërtimi i disa treguesve kyç të performancës
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Arsyetim

Duke pasur parasysh se ARRU, në vazhdimësi ka synim avancimin e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së KRU dhe me qëllim që ky proces të zhvillohet më tutje, të jetë me racional, efektiv dhe motivues, pas një analize të vlerësimit të tërë procesit, kemi parë mundësin e disa ndryshimeve në PMV.

Ndryshimi thelbësorë konsiston në peshën e Treguesve Kyç të Performancës (TKP), në këtë rast i'u është rritur pesha treguesve për të cilët konsiderojmë se janë me prioritet dhe janë kryesisht në mundësin e menaxhmentit dhe vetë KRU për ti përmirësuar. Po ashtu kemi ndryshuar emërtimin e disa treguesve, me qëllim që të jenë më të kuptueshëm për publikun e gjerë. Ndryshimet janë të paraqitura në SHTOJCEN që i është bashkangjitur këtij vendimi.

Treguesit si mbulueshmëria me shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura dhe cilësia e shkarkimit të ujërave të ndotura, do të hyjnë në vlerësim vetëm pasi të gjitha KRU-të të marrin në menaxhim ITUN në zonat e tyre respektive të shërbimit.

Duke u bazuar në faktet e përmendura dhe pas konsultimit me ofruesit e shërbimeve, ARRU ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes kundërshtim në Komisionin Shqyrtues në afat prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- Arkivit të ARRU-së;
- Departamentit të performancës;
- Kryeshefave të të gjithë KRU-ve



SHTOJCË:

Struktura e matjes së performancës (TKP dhe pesha e tyre)

Grupi	Njësia matëse e performancës	Koefficienti i nën-grupit		Koefficienti i Grupit	
Ujë	Cilësia e ujit të pijshëm	25%	100%	40%	100%
	Shtypja e ujit	5%			
	Vazhdimësia e furnizimit me ujë	15%			
	Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit	15%			
	Efiçienca e kostos - ujësjellës	15%			
	Uji i pa faturuar	25%			
Ujëra të ndotura	Cilësia e shkarkimit të ujërave të ndotura	20%	100%	30%	
	Performanca e rrjetit të kanalizimit	20%			
	Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit	20%			
	Mbulueshmëria me shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura	20%			
	Efiçienca e kostos - ujëra të ndotura	20%			
Të përgjithshme- Financiar dhe jo- financiar	Ankesat e trajtuar me kohë			5%	
	Besueshmëria e të dhënave			5%	
	Kthimi në kapital			10%	
	Shkalla e arkëtimit			10%	